

Në bazë të nenit 8 dhe neni 18 paragrafi (1) nënparagrafi 12 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19) dhe Ligjit për ndryshimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10 nga Ligji i njëjtë dhe neni 16 paragrafi (1) të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, në pajtim me Konkluzionin nr. 02- 647/6 datë 9.2.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 4- të mbajtur më 8.2.2023 miratoi si vijon:

V E N D I M

1. Miratohet rritje e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, nr. 05-4716/1 datë 22.12.2022.

Të hyrat dhe shpenzimet totale të planifikuara sipas Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023 do të rriten për 1.000.000,00 denarë, përkatësisht do të arrijnë në 149.530.505,00 denarë.

2. Me rritjen nga pika (1) i këtij Vendimi sigurohen mjete financiare në vlerë të përgjithshme prej 1.000.000,00 denarë, të destinuara për:

- Dhënie të ndihmës së njëherëshme financiare për - Donacion për popullatën e lënduar në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë të prekur nga tërmeti katastrofal i datës 6.2.2023 në vlerë prej 1.000.000,00 denarë.

3. Sigurimi i mjeteve financiare nga pika (2) e këtij Vendimi zbatohen duke ndryshuar pozicionet e mëposhtme :

- **Të hyrat e përgjithshme** do të rriten për 1.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 148.530.505,00 denarë do të arrijnë në 149.530.505,00 denarë;
- Pika e të hyrave **Teprica e transferuar nga viti i kaluar** do të rritet për 1.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 53.530.505,00 denarë do të jetë 54.530.505,00 denarë;
- **Shpenzimet e përgjithshme** do të rriten për 1.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 148.530.505,00 denarë do të arrijnë në 149.530.505,00 denarë;
- Do vendoset pikë e re grupimi, e cila është **450 - Ndhima, donacione dhe dhënie (grante) të tjera për subjektet** dhe do të jetë 1.000.000,00 denarë, të destinuara për popullatën e lënduar në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë të prekur nga tërmeti katastrofal i datës 6.2.2023;
- Do vendoset dhe pozicion i ri **450100 - Ndhima, donacione dhe dhënie të tjera për subjektet**, e cila do të arrijë 1.000.000,00 denarë;

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, është e nevojshme të kryej rritje në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2023, me qëllim sigurimin e mjeteve të destinuara për ndarjen e ndihmës së njëherëshme financiare - Donacion për popullatën e lënduar në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë e prekur nga tërmeti katastrofal më datë 6.2.2023.

Për rritjen e të ardhurave është e nevojshme të bëhen ndryshime të pozicioneve të mëposhtme miratuar në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2023. Pika e të hyrave Teprica e mjeteve të transferuara nga viti i kaluar do të rritet për 1.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 53.530.505,00 denarë do të jetë 54.530.505,00 denarë.

Gjegjësisht, me rritjen e propozuar të planit financiar për vitin 2023, të hyrat totale të planifikuara sipas planit do të rriten për 1.000.000,00 denarë, përkatësisht do të arrijnë në 149.530.505,00 denarë.

Për sigurimin e mjeteve në vlerë prej 1.000.000,00 denarë, është e nevojshme që të kryhen ndryshime të pozicioneve të radhës në planin financiar të miratuar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2023 dhe atë: Do vendoset pozicioni i ri grupor i cili thotë 450-Ndihma, donacione dhe dhënie të tjera subjekteve dhe do të jetë 1.000.000,00 denarë, të destinuara për dhënien e njëherëshme të ndihmës financiare për popullatën e lënduar (vuajtur) në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë të prekur nga tërmeti katastrofal i datës 6.2.2023. Do vendoset dhe pozicioni i ri 450100 - Ndihma, donacione dhe dhënie të tjera të subjekteve, e cila do të arrijë në 1.000.000,00 denarë.

Gjegjësisht, me rritjen e propozuar të planit financiar për vitin 2023, shpenzimet totale të planifikuara sipas planit do të rriten për 1.000.000,00 denarë, përkatësisht do të arrijnë në 149.530.505,00 denarë.

Rrjedhimisht nga sa u tha më lart, dhe bazuar në nenin 8 dhe nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 12 i Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44 /14, 101 /14, 132/14 , 142/16 , 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe Ligjit për ndryshimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10 të Ligjit të njëjtë dhe neni 16 paragrafi (1) të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, në pajtim me Konkluzionin nr. 02- 647/6 datë 9.2.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive në seancën e 4- të mbajtur më 8.2.2023, miratoi vendim si në dispozitiv.

Nr. 05-679/1

09.02.2023
Shkup

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizive,
Krytari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI d.v